

KUMTESEË PËR PUBLIKUN

Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës solli aktvendim me të cilin konstatoi ekzistencën e sjelljes së bashkërenduar (kartel) ndërmjet dhjetë kompanive të sigurimit (EVROINS SIGURIM SHA SHKUP, TRIGLAV SIGURIM SHA SHKUP, SHA MAQEDONIA SHKUP VIENA INSURANCE GROUP, SAVA SIGURIM SHA SHKUP, EUROLINK SHA SHKUP, GRAVE SHA SHKUP, UNIKA SHA SHKUP, SHA POLISA E SIGURIMIT SHKUP, HALK SIGURIM SHA SHKUP DHE KROACIA SIGURIM SHA SHKUP) në tregun e sigurimit nga përgjegjësia e automobilave (PA), të cilin çdo pronar i automjetit motorik duhet ta paguajë detyrimisht gjatë regjistrimit të automjetit.

Në procedurë u konstatua se kompanitë e sigurimit, në periudhën 01.03.2024 – 07.05.2024, shkëmbejnë informacione të ndjeshme, koordinonin aktivitete dhe në një afat jashtëzakonisht të shkurtër sollën vendime identike ose ndërmjet tyre të harmonizuara për rritjen e pjesës së primit për kryerjen e veprimtarisë, të ashtuquajturën shtesë regjie.

Një sjellje e tillë paraqet kufizim të konkurrencës "për nga vetë qëllimi", gjegjësisht formën më të rëndë të shkeljes sipas Nenit 7 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Shkëmbimi i informacioneve dhe sjellja paralele e vendimeve për çmime e zëvendëson politikën e pavarur afariste me veprim kolektiv të koordinuar në treg, gjë që është rreptësisht e ndaluar.

Në bazë të fakteve të konstatuara, Komisioni shqiptoi sanksione për kundërvajtje – gjoba, në vlerë të përgjithshme prej 17.266.930 denarësh.

Komisioni mbetet i përkushtuar në mbrojtjen e kushteve fer të tregut, parandalimin e karteleve dhe sigurimin e një ambienti konkurrues në interes të konsumatorëve dhe ekonomisë.